

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

VENDIM
Nr. 365, datë 10.07.1995.

PËR
NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.451, DATË
16.09.1993 “PËR ADMINISTRIMIN E SHPELLAVE”

Me propozimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes së Mjedisit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.451, datë 16.09.1993, pika 5 ndryshohet si vijon :
“Tarifa e shërbimit (dhënie liçence dhe informacion) për ekipet e huaja deri në 10 veta dhe me periudhë eksplorimi të shpellave deri në 15 ditë caktohet në masën 50 USD. Për grupe më të mëdha se 10 veta ose me periudhë eksplorimi më të gjatë se 15 ditë, vlera e mësipërme dyfishohet.”

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
ALEKSANDËR MEKSI